



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1201/6 prot

Datë 23.06.2022

V E N D I M

Nr.583/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.06.2022 me

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “BE-IS” SHPK& “ERGI” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-25396-04-15-2022, me objekt "Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën e Autostradës Tiranë -Durrës ", me fond limit 261,334,752.63 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 05.05.2022 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Ujesjellës Kanalizime Tiranë Sh.A
Rruga Kavajës Nr.133, Njësia administrative
Nr.6,Kodi Postar 1027
- Ankimues:** BOE “BE-IS” SHPK& “ERGI” SHPK
Lagjia nr.1, pallati Metalurgu, Hyrja nr.1
Tiranë/Elbasan
- Baza Ligjore:** Nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.04.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-25396-04-15-2022, me objekt “Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën e Autostradës Tiranë -Durrës”, me fond limit 261,334,752.63 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 05.05.2022 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tiranë.

II.2. Në datën 05.05.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 30.05.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

BE IS	186,425,950	I skualifikuar
Alba Konstruksion	189,925,910	I skualifikuar
LTE	232,817,029	I kualifikuar

ANK	244,908,422	I kualifikuar
4AM	248,247,667	I kualifikuar

II.4. Në datën 30.05.2022 BOE BE-IS” SHPK& “ERGI” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Oferta e paraqitur nga BOE "BE-IS" sh.p.k & "Ergi" sh.p.k, me vlerë të ofertës 186.425.950 (Njëqind e tetëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e njëzet e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 82, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", dhe të Kreut X Nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik", I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi se oferta nuk i përmbush të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit.

Bazuar në kriterin 2.3.11 pika (f) të kapacitetit teknik në DST ku kërkohet: f)Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sh.a dhe Bashkia Tiranë (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi). KVO vendos skualifikimin e operatorit ekonomik "BOE "BE-IS" sh.p.k & "Ergi" sh.p.k për arsyet si më poshtë: BOE ka paraqitur në vëtedeklarim të njëjtat mjete që ka paraqitur në procedura të tjera prokurimi në Bashkinë Tiranë ku ka lidhur kontrata konkretisht si më poshtë: BE-IS sh.p.k në Bashkinë Tiranë: Në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Bashkia Tiranë me objekt : "Ndertim i segmentit rrugor dhe pedonales nga sheshi "Federik Shopen" deri në kryqëzimin me Rrugën e Kosovarëve, operatori ekonomik fitues "BE-IS" sh.p.k ka deklaruar të njëjtat mjete të cilat i ka deklaruar ne proceduren e prokurimit me objekt "Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën e Autostradës Tiranë -Durrës" konkretisht si më poshtë: Mjeti me targë AA 108HK në pronësi me Nr Leje Qarkullimi TRF1224213 Mjeti me targë AA356SF në pronësi me Nr Leje Qarkullimi TRDA3612617 Mjeti me targë AA782FA në pronësi me Nr Leje Qarkullimi TRDB069 Gjithashtu janë deklaruar të njëjtat mjete si dhe në Bashkinë Tiranë në kontratat e lidhura midis BE-IS sh.p.k & Ergi sh.p.k dhe Bashkia Tiranë me Nr 12227/5Prot datë 07.06.2021 me afat kohor 16 muaj kalendarikë nga data e lidhjes së kontratës. Objekti I Kontrates të nënshkruar me Bashkinë Tiranë është si më poshtë: Riforcimi I Njësive të Banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkinë e Tiranës. Në këtë kontratë përfshihen ndërtesat si më poshtë: Riaftësimi Strukturor i Ndërtesës "Klara 1" Rruga "Sejdini" Riaftësimi Strukturor i Ndërtesës "Klara 2" Rruga "Sejdini" Riaftësimi Strukturor i Ndërtesës "Pallati 88/4" Rruga "Panorama"

Riaftësimi Strukturor i Ndërtesës “Pallati 37” Rruga “Medar Shtylla” Riaftësimi Strukturor i Ndërtesës “Pallati 26” Rruga “Margarita Tutulani” Mjetet e deklaruara për ketë kontratë nga BE-IS sh.p.k janë: Mjeti me targë AA356SF në pronësi me Nr Leje Qarkullimi TRDA3612617 Mjeti me targë AA782FA në pronësi me Nr Leje Qarkullimi TRDB069 Mjeti me targë AA108HK në pronësi me Nr Leje Qarkullimi TRF1224213 Mjetet e deklaruara nga Ergi sh.p.k janë: Mjeti me targë EL1401C në pronësi me Nr Leje Qarkullimi ELD0012234 Mjeti me targë AA157CD në pronësi me Nr Leje Qarkullimi ELF0277411 Mjeti me targë AA557NB në pronësi me Nr Leje Qarkullimi TRDB0088015 Mjeti me targë AA848BN në pronësi me Nr Leje Qarkullimi ELD1281519 Në përmbushje të kriterit 2.3.11 të kapacitetit teknik BO BE-IS sh.p.k dhe Ergi sh.p.k kanë paraqitur të rregullta deklaratimet për mjetet si më poshtë: BE-IS sh.p.k 1. AA761DH me Nr Leje Qarkullimi PED0958512 me qera me Nr kontrate qeraje Nr 67Prot datë 03.05.2022 deri në përfundim të objektit. 2. AA418MA me Nr Leje Qarkullimi TRDA6023515 me qera me Nr kontrate 9902Rep, Nr 3808Kol datë 08.09.2020 deri në datë 08.09.2022. 3. AA485GM me Nr Leje Qarkullimi SHD0253315 me qera me Nr kontrate Nr68Prot datë 04.05.2022 deri në përfundim të objektit. Ergi sh.p.k 1. AA023PM me Nr Leje Qarkullimi DRD0027817 me qera me afat 29.04.2022 deri në përfundim të kontratës. 2. AB379AB me Nr Leje Qarkullimi ELD0303920 me qera me Rep1448, Kol 827 datë 01.04.2020 deri më datë 31.03.2023. 3. AA211VS në pronësi me Nr Leje Qarkullimi ELD0905518. 4. AA367HC në pronësi me Nr Leje Qarkullimi ELD1037713 Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihen në dispozicion pesë kamionë kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. BOE në përmbushje të këtij kriteri nga pesë kamiona ka paraqitur vetëm tre kamion me tonazhin e kërkuar nga AK (të vlefshëm). Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 8 , është i paplotë lidhur me kamionat vetshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton për secilin kamion te kerkuar nga AK (5 cope), për rrjedhojë i pavlefshëm. Përsa cituam më lart bashkimi i operatorëve ekonomikë nga pesë kamiona disponon vetëm tre mjete të paangazhuara për realizimin e kontratës object prokurimi nëse do shpallej fitues. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihen në dispozicion katër kamionë kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 5 ton dhe maximum 10 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. BOE në përmbushje të këtij kriteri nga katër kamiona ka paraqitur vetëm një kamion me tonazhin e kërkuar nga AK (të vlefshëm). Përsa cituam më lart bashkimi i operatorëve ekonomikë nga katër kamiona disponon vetëm 1 mjet të paangazhuar për realizimin e kontratës object prokurimi nëse do shpallej fitues Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga BOE lidhur me shtojcën 8 , është i paplotë lidhur me kamionat vetshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton për secilin kamion te kerkuar nga AK (4 cope), si dhe minimumi 3,5 maximumi 5 ton për rrjedhojë i pavlefshëm. Duke qënë se të dy operatorët ekonomikë(bashkimi i opertorëve ekonomikë) i kanë të angazhuara mjetet me Bashkinë Tiranë KVO gjykon se operatorët ekonomikë nuk disponojnë numrin e plotë sipas kërkesave të AK. Përsa më sipër, duke qënë se BOE nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 92 pika 3 Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të

pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje, të nenit 92, të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu X, neni 82, pika 2, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

II.5. Në datën 02.06.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e **Njoftim-Fituesit** në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 06.06.2022 në Sistemin e Ankesave Elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr.1201/2022 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2258 e BOE “BE-IS” SHPK& “ERGI” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së BOE “BE-IS” SHPK& “ERGI” SHPK dhe mbi kualifikimin e ofertës së BOE “LTE Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesave, i publikoi ato në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1201/2 datë 07.06.2022 me arsyet e skualifikimit të ankimuesit si dhe kriteret të cilat BOE ankimues pretendon se nuk përmbushen nga BOE “LTE Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 1201/4 datë 16.06.2022 Komisioni i Prokurimit publik kërkoi nga ana e autoritetit kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e BOE“BE-IS” SHPK&”ERGI” SHPK si dhe vendimin e autoritetit lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.9. Me shkresën nr.7454/1 prot, datë 15.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1201/5 prot datë 20.06.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues. Referuar aktit të trajtimit të ankesës rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës së BOE “BE-IS” SHPK&”ERGI” SHPK me argumentat si më poshtë:

Komisioni i Shqyrtimit të ofertave duke u bazuar në pretendimet si më sipër gjykon se: Pas verifikimit të dokumentacionit provues për pretendimet e ngritura nga ana e BOE BE-IS shpk&Ergi shpk KSHA arrin në përfundimin se pretendimet e ankimuesit qëndrojnë dhe si rrjedhim ankesa pranohet.

II.10. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, rezulton se BOE “LTE Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK në cilësinë e subjektit të interesuar nuk ka paraqitur argumenta në përputhje me nenin 113 të LPP-së pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e BOE “BE-IS” SHPK&”ERGI” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij dhe kualifikimin e “LTE Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr.7454/1 prot, datë 15.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1201/5 prot datë 20.06.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues. Referuar aktit të trajtimit të ankesës rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës së BOE “BE-IS” SHPK&”ERGI” SHPK me argumentat si më poshtë:

Komisioni i Shqyrtimit të ofertave duke u bazuar në pretendimet si më sipër gjykon se: Pas verifikimit të dokumentacionit provues për pretendimet e ngritura nga ana e BOE BE-IS shpk&Ergi shpk KSHA arrin në përfundimin se pretendimet e ankimuesit qëndrojnë dhe si rrjedhim ankesa pranohet.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga BOE “BE-IS” SHPK&”ERGI” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-25396-04-15-2022, me objekt "Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën e Autostradës Tiranë -Durrës ", me fond limit 261,334,752.63 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 05.05.2022 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “BE-IS” SHPK&”ERGI” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

